



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 35, datë 01/07/2004

**“PËR  
PLANIN E INVESTIMEVE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË SË  
TIRANËS PËR RIKONSTRUKSIONIN E TREGJEVE, PËR VITIN  
2004”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt. 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.7776 dt. 22/12/1993 “Për buxhetin local” me ndryshimet përkatëse, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

I. Plani i investimeve për vitin 2004 nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës miratuar më vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004, për rikonstruksionin e disa tregjeve në qytetin e Tiranës bëhet si më poshtë;

1. Rikonstruksioni i tregut në Pazarin e Ri:	10.070.000
- Rikonstruksioni i Sheshit Avni Rustemi	3.000.000 lekë
- Rikonstruksioni i Tregut Fruta-Perime Gastronomi	2.680.000 “
- Rikonstruksioni i Markatës së mishit	3.500.000 “
- Meremetim i nyja sanitare Pazari i Ri dhe zyra	890.000 “
2. Rikonstruksioni i tregut në Laprakë:	3.461.000 lekë
3. Rikonstruksioni i tregut në Kombinat:	6.022.000 lekë
4. Rikonstruksioni i sheshit të tregut në rrugën “Hamdi Pepa” dhe rikonstruksion zyrash lekë	10.000.000

**II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**